

MENDIM PARALEL

1. Unë komisionere Xhensila Pine, kryesuese e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit Adelina Zarka, kam votuar për pranimin e kërkesës së subjektit për çeljen e hetimit mbi dy kriteret e tjera të vlerësimit, të figurës dhe të aftësive profesionale, për sa kam çmuar se në kushtet kur subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit i janë kërkuar shpjegime për mosdeklarimin në deklaratën për kontrollin e figurës në pjesën 5 të saj, lidhur me udhëtimet në sistemin *TIMS* të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vitet 2005 dhe 2009 jashtë kufijve të Shqipërisë me shtetasin R. Xh., i cili rezultoi i dënuar për një nga veprat e parashikuara nga pika 15, e nenit 3, e ligjit nr. 84/2016.

1.1 Pasi subjekti i rivlerësimit dha prova dhe shpjegime lidhur me sa më sipër, pranimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit mbi dy kriteret e tjera të vlerësimit, të figurës dhe aftësive profesionale do të mundësonte arsyetimin lidhur me këtë komponent, pjesë e hetimit administrativ të kryer ndaj subjektit.

2. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, kam votuar pro shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar se mospranimi nga ana e shumicës së trupit gjykues të kërkesës së subjektit për çeljen e hetimit mbi dy kriteret e tjera të vlerësimit, të figurës dhe aftësive profesionale, nuk do të ndikonte në arsyetimin tim paralel lidhur me kriterin e pasurisë, i cili ka konsistuar si vijon:

2.1 Deklarimi i subjektit se shitja e apartamentit të banimit me sip. 66.04 m² prej saj dhe bashkëshortit referuar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 17.5.2000, ishte parashikuar kundrejt vlerës 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, por realisht ishte kryer kundrejt vlerës 4.450.000 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë), bie ndesh me legjislacionin në fuqi, i cili ka qenë i qartë edhe në drejtim të pasojave ligjore për subjektet. Firmosja e kontratës nr. ***, datë 17.5.2000, e cila u pranua nga subjekti se përmbante elemente fiktive lidhur me çmimin bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtare, e cila edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron dhe cenon besimin e publikut te drejtësia.

2.2 Ushtrimi i veprimtarisë së subjektit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, kur me vendimin nr. ***, datë 24.7.2018, ka marrë në shqyrtim çështjen gjyqësore me palë kërkuese Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe palë kallëzuese shoqërinë tregtare “****” sh.a. në periudhën kur shoqëria tregtare “****” sh.a. vijonte marrëdhëniet kontraktuale të qirasë me bashkëshortin dhe familjarët e tij si dhe vendimi i dhënë nga subjekti për babain e bashkëshortit të saj tregojnë mungesë kujdesi nga ana e subjektit për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e dorëheqjes për të shmangur çdo dyshim për paanësinë e saj në gjykim, marrin një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë sipas përcaktimeve të pikave 4 dhe 5, të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, dhe cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

Në përfundim, për shkak të ekzistencës së shkeljeve të referuara më sipër, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dështoi të kalonte testin e moscenimit të besimit të publikut, duke bërë të zbatueshëm parashikimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE
Kryesuese